

Drita M. Fazlia, PhD<sup>1</sup>

UDC: 328.36:355.40(497.7)

355.40:342.738(497.7)

## **PËRMBAJTJA E MARRËVESHJES PËR ARBITRAZHIN**

### **СОДРЖИНА НА АРБИТРАЖНИОТ ДОГОВОР**

### **CONTENTS OF THE ARBITRATION AGREEMENT**

#### **Abstract**

A very important fact for determining arbitration is how the parties consent. Thus, the parties can consent to settle disputes through the arbitration agreement, or they have given their consent only for the final disputes, which may arise from the concrete binding report. Consequently, the parties following the autonomy of the will, can express their consent through the compromise for arbitration or through the arbitration clause.

As such, the parties' autonomy of the will, represents the sovereign right of each subject to decide whether it will resolve the dispute through the judicial, non-judicial or political instrument.

That is why the autonomy of the parties' will is a condition for consent, and for addressing the dispute in any peaceful instrument.

Given that the dispute is based on the opposite interests of the parties, it is obvious that there is a weak point in the dispute, which constitutes the subject of the dispute. In situations of disagreement on the arbitration agreement, the parties' will is not expressed and determined in accordance with the terms that need to be agreed upon in the further procedure. On the other hand, if the arbitration compromise does not contain the essential issues for implementing the law and the whole

---

<sup>1</sup> Proferoreshë në Fakultetin Juridik pranë Universitetit të Tetovës. Email: [drita.fazlia@unite.edu.mk](mailto:drita.fazlia@unite.edu.mk)

process, this leaves room for non-compliance of the compromise and the decision as to the final settlement of the dispute.

**Keywords:** *Arbitration, arbitration agreement, pathological clause, blank clause, arbitration jurisdiction, etc.*

## 1. Hyrje

Që nga vitet e 70-ta të shekullit të kaluar, duke shkruar për elementet e plotfuqishmërisë së marrëveshjes për arbitrazhin dhe për të ashtuquajturat klauzolat patologjike *Frederic Eisemann*<sup>2</sup> ka konstatuar disa funksione kyçe të marrëveshjes për arbitrazhin, të cilat duhet të merren parasysh gjatë përpilimit të kompromisit për arbitrazhin, sipas të cilëve ajo duhet:

- T'i detyrojë palët kontestuese për zbatimin e marrëveshjes;
- Ta përjashtojë zgjidhjen gjyqësore, të paktën deri në momentin e shqiptimit të vendimit të arbitrazhit;
- T'i autorizojë arbitrat t'i zgjidhin kontestet të cilat mund të paraqiten midis palëve kontestuese;
- Të mundësojë procedurë efikase të arbitrazhit, rezultati i së cilës do të jetë vendimi i cili më vonë do të jetë i përshtatshëm për zbatim.

Por, pavarësisht këtyre kushteve që propozohen të merren parasysh gjatë përpilimit të kompromisit për arbitrazhin, palët gëzojnë autonomi të plotë për ta përcaktuar kornizën e autorizimeve të arbitrave në veçanti dhe tribunalit të arbitrazhit në përgjithësi. Këtë liri e parashikojnë, si burimet që e trajtojnë arbitrazhin juridik-privat, ashtu edhe ato të arbitrazhit juridik-publik.

Në përputhje me nenin 52 të Konventës së Hagës (1907), përcaktimi i saktë i përmbajtjes në kuadër të kompetencave në kompromis është shumë i rëndësishëm, për rregullimin e procesit të mëtejshëm, në bazë të të cilit do të merret vendimi. Më konkretisht, kompromisi qartë e përcakton lëndën e kontestit, afatin për emërimin e arbitrave, afatin brenda të cilit duhet të merret vendimi dhe lartësinë e shumës të cilën palët duhet ta lënë në formë të depozitës për shpenzimet. Palëve gjithashtu, u jepet hapësirë ta përcaktojnë mënyrën e emërimit të arbitrave,

---

<sup>2</sup> Frederic Eisemann, *La clause d'arbitrage pathologique*, në *Commercial Arbitration Essays in memoriam Eugenio Minoli*, Torino: Unione Tipografico-Editrice Torinese, 1974.

gjuhën me të cilën do të shërbehen dhe të gjitha çështjet për të cilat palët vlerësojnë që duhet të theksohen në kompromis.<sup>3</sup>

Gjithashtu, identiteti i arbitrave, formulimi i çështjes e cila duhet të parashtrahet në arbitrazh, e drejta e cila do të zbatohet, afati<sup>4</sup> brenda të cilit duhet të merret vendimi, janë disa nga çështjet kyçe të cilat duhet të theksohen në marrëveshjen midis palëve.<sup>5</sup> Funksionimi i arbitrazhit e arrin qëllimin nëse përmbushen kushtet dhe çështjet të cilat janë të theksuara në marrëveshje.<sup>6</sup> Për më tepër, marrëveshja i përfshin të gjitha rregullat, të cilat janë të pranuar nga palët, në veçanti:<sup>7</sup>

- Të drejtën kompetente dhe parimet të cilat do të zbatohen nga ana e tribunalit ose në qoftë se palët kanë parashikuar që tribunali të vendosë në bazë të parimit të drejtshmërisë *-aequo et bono*;

- Autorizimin që tribunali t'u japë rekomandim palëve;

- Autorizimin që tribunalit i jep të drejtë t'i përcaktojë vetë rregullat e procedurës;

- Procedura e cila duhet të ndiqet nga ana e tribunalit, me kusht që fillimisht të themelohet, tribunali të jetë i lirë ta shmangë cilëndo dispozitë e cila mund ta parandalojë atë nga marrja e vendimit;

- Numrin e anëtarëve të nevojshëm për krijimin e kuorumit për zhvillimin e diskutimit;

- Shumicën e nevojshme për marrjen e vendimit;

- Afatin brenda të cilit duhet të merret vendimi;

- Të drejtën e anëtarëve të tribunalit për t'u deklaruar për vendimin;

- Gjuhën me të cilën do të shërbehen gjatë procedurës;

- Mënyrën e shpërndarjes së shpenzimeve;

- Shërbimet juridike, të cilat palët i kanë në dispozicion nga ana e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.

<sup>3</sup> Nenet 52 dhe 58 të Konventës së Hagës (1907).

<sup>4</sup> Afati i përcaktuar në marrëveshje mund të vazhdohet me pëlqimin e përbashkët nga palët ose nga ana e tribunalit nëse ai vlerëson që ajo është e domosdoshme në mënyrë që të merret vendim i drejtë.

Neni 63 nga Konventa e Hagës për Zgjidhje Paqësore të Kontesteve nga viti 1907.

<sup>5</sup> Më shumë për format dhe rastet në të cilat më shpesh në praktikë paraqiten klauzolat patologjike, Pierre A. Karrer, *Pathological Arbitration Clause: Malpractice, Diagnosis and Therapy*, në *The International Practice of Law: Liber Amicorum for Thomas Bär and Robert Karrer*, Nedim Peter Vogt (editor), Basel: Helbing & Lichtenhahn, 1997, 111-117.

<sup>6</sup> Rebecca M.M. Wallace, *International Law*, London: Sweet&Maxwell, 1986, 239-340.

<sup>7</sup> Drita M. Fazlia, Faton Shabani, *Zgjidhja jashtgjyqësore e kontesteve*, Arbëria Design, Tetovë, 2019, 103

Në përgjithësi, nga kjo mund të arrihet në përfundimin që kompromisi për arbitrazhin është elementi kyç, i cili mund të jetë arsyeja për kërkesën për shpalljen e pavlefshme ose për ndryshimin e vendimit të marrë në bazë të kompromisit me mungesa. Për t'iu shmangur situatave të tilla, në ndihmë vijnë Rregullat model, të cilat parashikojnë të paktën tri elemente të detyrueshme që duhet t'i përmbajë kompromisi për arbitrazhin:<sup>8</sup>

- Përcaktimi që kontesti duhet t'u parashtrohet arbitrave për zgjidhje;

- Lënda e kontestit;

- Metoda e themelimit të tribunalit dhe numri i arbitrave që do të përmbajë tribunali.

Lidhur me përmbajtjen e marrëveshjes për arbitrazhin, respektivisht, me mungesat që mund të hasen në të, duhet të bëhet dallimi se përmes saj është kontraktuar arbitrazhi i përhershëm ose i përkohshëm. Nëse bëhet fjalë për formën e parë të arbitrazhit, për të gjitha çështjet lidhur me zgjidhjen e kontestit të cilat nuk janë parashikuar në marrëveshje, do të vlejnjë rregullat e Rregullores së arbitrazhit apo rregullat e së drejtës së shtetit në të cilin ndodhet selia e arbitrazhit. Nga ana tjetër, palët duhet të jenë shumë të kujdesshme kur lidhin marrëveshje për arbitrazhin e përkohshëm, sepse në atë rast, është më e vështirë të caktohen zgjedhje alternative për çështjet që palët nuk i kanë dakorduar, për faktin se te arbitrazhi i përkohshëm nuk ka rregullore si në rastin e arbitrazhit të përhershëm.<sup>9</sup>

## 2. Përcaktimi i kompetencës së arbitrazhit

Parakusht për iniciimin e procedurës për zgjidhjen e kontestit të caktuar përmes arbitrazhit është që, palët përmes autonomisë së tyre në mënyrë të qartë të japin autorizim që për zgjidhjen e kontestit të tyre, kompetent të jetë arbitrazhi. Pëlqimin për zgjidhjen e kontestit përmes arbitrazhit duhet ta japin të gjitha palët në kontest dhe forma përmes së cilës ato e autorizojnë arbitrazhin duhet të jetë konkrete me qëllim që të shmangen situatat e paraqitjes së mangësive të mundshme, që më vonë do ta pamundësonin ose vështirësonin fillimin e procedurës së arbitrazhit.

<sup>8</sup> Neni 2(1) i Rregullave model.

<sup>9</sup> Gary B. Born, *International Arbitration and Forum Selection Agreements: Drafting and Enforcing*, Alphen aan den Rijn: Kluwer Law International, 2010, 44-45.

## 2.1. Klauzolat patologjike

Ajo që e bën të veçantë arbitrazhin si instrument jashtëgjyqësor për zgjidhjen e kontesteve është pikërisht shprehja e vullnetit të palëve në kontest apo arritja e marrëveshjes së palëve që kontestin e tyre t'ia besojnë arbitrazhit të caktuar. Mirëpo, ky përcaktim i vullnetit të palëve, apo pëlqimi i tyre për ta autorizuar arbitrazhin e caktuar duhet të jetë i shprehur në mënyrë të saktë dhe precize, sepse në të kundërtën, mund të dyshohet në vullnetin e palës/palëve, gjë që e pamundëson përcaktimin e kompetencës së arbitrazhit për zgjidhjen e kontestit të caktuar.

Nga praktika e zgjidhjes së kontesteve përmes arbitrazhit, janë vërejtur disa raste që kanë vështirësuar apo pamundësuar përcaktimin e kompetencës së arbitrazhit. Këto raste zakonisht janë paraqitur te klauzolat për arbitrazhin, të cilat ish-sekretari i përgjithshëm i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë *Frederic Eisemann* në vitin 1974 i kishte quajtur klauzola patologjike të arbitrazhit. Ai, klauzolat patologjike i përkufizon si marrëveshje për arbitrazhin të cilat përmbajnë mangësi të caktuara dhe të cilat shkaktojnë dilema dhe vështirësi për zhvillimin e procedurës së arbitrazhit.<sup>10</sup> Prej këtu, ky emërtim përdoret për klauzolat të cilat nënkuptojnë shprehjen e autonomisë së palëve me mungesa apo për klauzolat të cilat nuk janë të përkufizuara në mënyrën e duhur, nga të cilat në jo pak raste lindin konteste rreth interpretimit të tyre.

Mangësitë më të shpeshta që janë identifikuar si rezultat i mos-përkufizimit të saktë të marrëveshjes apo klauzolës për arbitrazhin, rezultojnë rastet kur palët gjatë përpilimit të klauzolës,<sup>11</sup> nuk i kanë përdorur shprehjet e përshtatshme, kanë përdorur shprehje pa kuptim ose shprehje me dy kuptime. Për shembull: “(...) në qoftë se vjen deri te mosrealizimi i të drejtave dhe mospërmbushja e detyrimeve të ndërsjella, që rrjedhin nga raporti i kontraktuar, atëherë atë kontest mund ta zgjidhë arbitrazhi (...)”. Nga ky përkufizim, mund të shihet që nuk ka vendosmëri të plotë te palët që të përcaktohen kompetencat e

<sup>10</sup> Frederic Eisemann, La clause d'arbitrage pathologique, në *Commercial Arbitration Essays in memoriam Eugenio Minoli*, Torino: Unione Tipografico-Editrice Torinese, 1974, 129.

<sup>11</sup> Zakonisht 'patologjia' shprehet në klauzolat e arbitrazhit, pasi që aty palët e shprehin vullnetin e tyre që kontestin ta zgjidhë arbitrazhi para se të lindë kontesti dhe në këtë situatë palët nuk mbajnë shumë llogari për përcaktimin sa më të saktë. Ndërsa, kur bëhet fjalë për marrëveshjen e arbitrazhit, atëherë kontesti tashmë ka lindur midis palëve dhe palët i kanë të qarta rrethanat dhe kushtet, prandaj në këtë rast ato mbajnë më shumë llogari që elementet e shprehura të jenë të përcaktuara mirë. Për këtë arsye, mangësitë më shumë paraqiten te klauzolat patologjike.

arbitrazhit, për shkak që shprehja ‘mund’ paraqet vetëm opsion të mundshëm, por jo edhe opsion të zgjedhur nga palët. Në këtë rast nuk mund të themi që palët e kanë dhënë pëlqimin e tyre për zgjidhjen e kontestit eventual nga ana e arbitrazhit, por, kuptohet që, palët nga të gjitha instrumentet për zgjidhjen e kontesteve ndoshta do të zgjedhin arbitrazhin, duke lënë hapësirë edhe për zgjedhjen e instrumenteve të tjera. Pra, vetë shprehja ‘mund’ krijon pasiguri në vendosmërinë e palëve që kontestin e tyre ta zgjidhë arbitrazhi.

Gjithashtu, nëse palët për shembull në një kontest trepalësh me interesa të kundërt, e kanë zgjedhur një tribunal të përbërë prej tre anëtarëve. Këtu paraqitet problem emërimi i arbitrit të tretë, për shkak se, palët do të emëronin nga një arbitër, por arbitrat mes tyre nuk do të mund ta emëronin kryetarin e tribunalit të arbitrazhit. Në këtë rast, do të mungonte elementi i ‘paanshmërisë’.

Në fund, mangësi mund të paraqesë dhënia e pëlqimit të përgjithshëm për instrumentin e arbitrazhit, duke mos përcaktuar cilit institucion të arbitrazhit i referohen palët apo duke theksuar që kompetent do të jetë ndonjë institucion i arbitrazhi i cili nuk ekziston.<sup>12</sup>

## 2.2. Klauzolat ‘e bardha’

Klauzolat ‘e bardha’ (*Clause blanche*) paraqesin klauzolat të cilat nuk përmbajnë asnjë përcaktim në aspekt të asaj se si do të emërohen arbitrat, as në mënyrë direkte e as përmes adresimit të rregullave të caktuara të arbitrazhit ose të institucionit të arbitrazhit.<sup>13</sup> Mirëpo edhe përkundër faktit që klauzolat e tilla më shumë vijnë në shprehje në momentin kur nuk është dhënë ndonjë shenjë ose autorizim i qartë për emërimin e arbitrave, përsëri klauzolat ‘e bardha’ u referohen edhe atyre klauzolave në të cilat palët japin pëlqimin e përgjithshëm dhe asgjë më tepër. Për shembull, palët kanë mundësi që të japin autorizim që kontesti do të zgjidhet përmes arbitrazhit, që paraqet një autorizim të

<sup>12</sup> Më shumë për format dhe rastet në të cilat më shpesh në praktikë paraqiten klauzolat patologjike, Pierre A. Karrer, *Pathological Arbitration Clause: Malpractice, Diagnosis and Therapy*, në *The International Practice of Law: Liber Amicorum for Thomas Bär and Robert Karrer*, Nedim Peter Vogt (editor), Basel: Helbing & Lichtenhahn, 1997, 111-117, Drita M. Fazlia, Faton Shabani, *Zgjidhja jashtgjyqësore e kontesteve*, Arbëria Design, Tetovë, 2019, 105.

<sup>13</sup> Fouchard, Gaillard, Goldman, Emmanuel Gaillard, John Savage (editors), *International Commercial Arbitration*, Kluwer Law International, The Hague, London/New York, 1999, 266.

përgjithshëm, mirëpo, nuk përcaktohet se cili arbitrazh do të jetë ai. Këtu shfaqet dilema, nëse do të jetë arbitrazhi i brendshëm apo ndërkom-bëtar, a do të jetë arbitrazhi i përhershëm apo i përkohshëm dhe nëse do të jetë i përhershëm, atëherë cili do të jetë i tillë.

Gjithmonë parashtrohet pyetja: Çka ndodh në raste të tilla kur kemi të bëjmë me klauzola patologjike apo ‘të bardha’? Në përgjithësi, përgjigjja e kësaj pyetjeje është e konfirmuar, pasi që mbijetesa e klauzolave patologjike të arbitrazhit pikë së pari varet nga vullneti i palëve, respektivisht, nga bashkëpunimi i tyre. Në këtë kuptim, palët kanë mundësi që me lidhjen e marrëveshjes shtesë ta ‘rehabilitojnë’ klauzolën patologjike të arbitrazhit, që praktikisht e përbën situatën më të shpeshtë në praktikë. Por, problemet lindin atëherë kur ai vullnet te palët nuk ekziston, por përkundrazi, shkohet në drejtim të tejkalimit të zgjidhjes së kontestit përmes arbitrazhit. Në fakt, i pandehuri, zakonisht është ai i cili thirret në klauzolën patologjike të arbitrazhit dhe në bazë të saj edhe e kundërshton kompetencën e arbitrazhit. Siç është theksuar edhe më lart, kjo në rastin më të mirë e shtyn procedurën, për kohën e cila është e nevojshme për gjykatën e arbitrazhit për të marrë qëndrim lidhur me domethënien dhe qasjen e klauzolës patologjike. Skenari më i zyrtë është kur merret qëndrimi se klauzola e arbitrazhit është në mënyrë absolute e paqartë dhe në bazë të saj nuk do të mund të përcaktohet kompetenca e arbitrazhit. Në praktikën e arbitrazhit paraqiten qëndrime të ndryshme, por në përgjithësi është tendencë shprehja për “shpëtimin e asaj që mund të shpëtohet”. Patologjia me përfundim të keq është më shumë përjashtim sesa rregull.<sup>14</sup>

### 3. Përcaktimi i lëndës kontestuese

Palët kontraktuese me rastin e lidhjes së kompromisit, është e këshillueshme që në të t’i theksojnë autorizimet lidhur me përcaktimin e qartë të çështjes kontestuese, kohën për emërimin e arbitrave, formën dhe kohën për të cilën duhet të merret vendimi dhe lartësinë të cilën palët duhet ta lënë në formë të depozitës.<sup>15</sup>

Është detyrim i secilës palë që në mënyrë sa më të mirë ta definojë kontestin, pasi që arbitrazhi është i autorizuar vetëm për lëndën kontestuese. Në rast kur njëra palë nuk pajtohet me faktin që ekziston kontesti

<sup>14</sup> Gašo Knežević, Vladimir Pavić, Arbitraža i ADR, Beograd: Pravni Fakultet Univerziteta u Beogradu, 2009, 68.

<sup>15</sup> Neni XLIII i Paktit të Bogotës.

ose që kontesti tërësisht ose pjesërisht nuk bën pjesë në kompetencën e arbitrazhit, atëherë kontesti parashtrohet në gjykatë. Në këtë rast, tribunali ka të drejtë të vendosë për arbitralitetin e kontestit, ndërsa në raste kur tribunali i arbitrazhit ende nuk është i themeluar, atëherë cilido kontest lidhur me arbitralitetin do t'i referohet atij.<sup>16</sup>

Palët duhet të përgatitin marrëveshje të veçantë e cila do ta përcaktojë lëndën kontestuese dhe hollësitë për procedurën.<sup>17</sup> Kjo mundëson ekzistencë të mundësisë që të dyja palët të parashtrajnë në tribunal qëndrime personale për lëndën kontestuese, ashtu që në këto raste tribunali i arbitrazhit do të jetë kompetent për zgjidhjen e të dyja çështjeve kontestuese midis palëve. Vendimi për cilëndo çështje e cila nuk është e theksuar në kompromis, konsiderohet si tejkalim i kompetencave dhe autorizimeve, me çka jepet më shumë hapësirë për shpalljen e pavlefshme të vendimit. Pra, nga përcaktimi i saktë i kontestit varet edhe efikasiteti i tribunalit të arbitrazhit.

#### 4. Përcaktimi i selisë së arbitrazhit

Selia e arbitrazhit paraqet vendin, për të cilin palët janë dakorduar se do të zhvillohet procedura e tërësishme dhe do të merret vendimi përfundimtar. Përcaktimi apo zgjedhja e selisë së arbitrazhit është një ndër çështjet kyçe gjatë përpilimit të marrëveshjes për arbitrazhin, për shkak se ajo me vete përmban edhe përcaktimin për:<sup>18</sup>

- Të drejtën kompetente për arbitrazhin;
- Gjykatën e cila do të jetë kompetente për dhënie të ndihmës, por dhe mbikëqyrjen e arbitrazhit;
- Përkatesinë e arbitrazhit, që është veçanërisht e rëndësishme në aspekt të mundësive për anulimin, respektivisht, për njohjen dhe zbatimin e vendimit.

Sa i përket arbitrazheve të karakterit juridik-publik, vendin e arbitrazhit po ashtu e zgjedhin palët edhe pse selia e Gjykatës së Përherëshme të Arbitrazhit është në Hagë.<sup>19</sup> Kjo nënkupton se, nëse palët nuk janë dakorduar, atëherë selia do të jetë në Hagë. Vendi i selisë ku do të

<sup>16</sup> Neni 1 i Rregullave model.

<sup>17</sup> Neni 23 i Konventës së Evropiane për Zgjidhjen Paqësore të Kontesteve nga viti 1957.

<sup>18</sup> Michael Hwang, Fong Lee Cheng, Relevant Considerations in Choosing the Place of Arbitration, *Asian International Arbitration Journal*, 4/2, 2008, 195.

<sup>19</sup> Neni 36 i Konventës së Hagës (1899).



mbahen mbledhjet, i cili një herë është zgjedhur, nuk mund të ndryshohet, përveç me marrëveshjen nga vetë palët.<sup>20</sup> Selia e arbitrazhit është çështje për të cilën palët duhet të dakordohen dhe ta potencojnë në kompromis.<sup>21</sup>

Në rastin e zgjidhjes së kontesteve shumëpalëshe, nëse palët nuk e kanë përcaktuar të drejtën kompetente ose ndonjë të drejtë e cila nuk mund ta zgjidhë një çështje të caktuar, atëherë do të zbatohen rregullat procedurale të shtetit në të cilin gjendet selia. Selia e arbitrazhit në masë të madhe përfshin edhe fazën procedurale para dhe pas arbitrazhit. Në fazën e pas përfundimit të procedurës, për shembull, selia e arbitrazhit është e rëndësishme në raste kur zbatimi i vendimit të arbitrazhit kërkohet në shtetin e ndryshëm nga i cili është sjellë vendimi. Nëse është shteti në të cilin kërkohet zbatimi i vendimit, kërkon të jetë nënshkruar i Konventës së Nju Jorkut, gjykatat e tij do ta refuzojnë zbatimin, nëse vërtetohet që në aspekt të arbitralitetit (*ratio personae*), plotfuqishmërisë së marrëveshjes për arbitrazhin ose nëse në përbërjen e gjykatës së arbitrazhit janë shkelur normat imperative të vendit të arbitrazhit.<sup>22</sup>

## 5. Përcaktimi i mënyrës së financimit

Palët gëzojnë autonomi të plotë që vetë ta dakordojnë mënyrën e financimit, me ç'rast, zakonisht kur palët përcaktohen për arbitrazhin e përkohshëm, shpenzimet i paguajnë të dyjat me marrëveshje, ndërsa kur e zgjedhin arbitrazhin e përhershëm, ato pajtohen me normat që parashikohen në rregulloret e arbitrazhit në fjalë.

E njëjtë është situata edhe në rastin e arbitrazheve juridike-publike. Secila palë i paguan shpenzimet e saja, ndërsa në pjesë të barabartë i mbulojnë shpenzimet e Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit.<sup>23</sup> Në pajtim me vullnetin e palëve, ato përmes kompromisit e parashikojnë mënyrën e financimit dhe mbulimit të shpenzimeve.<sup>24</sup> Në mungesë të të dhënave të përmbajtura në kompromis, vlejnë normat nga pjesa e katërt e Konventës së Hagës e vitit 1907.<sup>25</sup>

<sup>20</sup> Neni 60 i Konventës së Hagës (1907).

<sup>21</sup> Neni XLIII i Paktit të Bogotës.

<sup>22</sup> Дејан Јанићијевић, Арбитражни споразум као основ арбитражног решавања вишестраних и комплексних спорова, *Зборник радова Правног Факултета у Нишу*, LIV, 85.

<sup>23</sup> Neni 85 i Konventës së Hagës (1907); Neni 57 i Konventës së Hagës (1899).

<sup>24</sup> Neni 2 i Rregullave model.

<sup>25</sup> Neni 24 i Konventës së Hagës (1907).

## 6. Përcaktimi i rregullave të procedurës

Pëlqimi për rregullat e procedurës nënkupton parashikimin e hollësishëm sa i përket parashtrimit të fakteve, mënyrës së realizimit të bisedës, gjuhës, metodave të parashtrimit të provave dhe dëshmimeve, (pa)mundësisë për thirrjen e personave të tretë, shqiptimit të masave të përkohshme, (pa)mundësisë së ndarjes së ndonjë mendimi nga ana e ndonjërit prej arbitrave, mënyrës së shpalljes së vendimit dhe metodave për përmbushjen e vendimit, etj.<sup>26</sup>

### Conclusion

There are two key elements that determine the type of arbitration agreement: the time of filing the dispute and the time of concluding the arbitration agreement. These elements do not always complement each other. If the parties have entered into a legal relationship and have defined their mutual rights and obligations in it, they have the right to include in the same agreement an institution that would be responsible for resolving the disputes that could arise in the future as a result of non-performance of the whole or part of the contract.

If the parties express their will that a particular arbitration will resolve the eventual disputes from the agreed essential report, then it is mentioned in the arbitration clause. But, if the parties in the essential report do not provide such a provision, it does not mean that they do not have the right to select the arbitration to resolve the dispute arising from such a report. The parties have the autonomy to express their will, even after submitting the dispute, that arbitration will be the instrument through which the dispute will be resolved. In this case, it is a matter of arbitration compromise or arbitration agreement.

---

<sup>26</sup> Shumë shpesh, palët dakordohen që rregullat e procedurës së arbitrazhit të jenë të njëjta me ato ekzistueset dhe të zbatueshmet, të cilat janë të përpunuara nga institucionet e njohura të arbitrazhit të përhershëm, në veçanti të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Љубомир Данило Фрчкоски, Сашо Георгиевски, Тајјана Петрушевска, Меѓународно јавно право, Скопје, Зумпрес, 1995, 591.

**Literatura e shfrytëzuar**

- Mauro Rubino–Sammartano, *International Arbitration: Law and Practice*, 2nd edition, The Hague: Kluwer Law International, 2001,
- Frederic Eismann, *La clause d'arbitrage pathologique*, në *Commercial Arbitration Essays in memoriam Eugenio Minoli*, Torino: Unione Tipografico-Editrice Torinese, 1974.
- Pierre A. Karrer, *Pathological Arbitration Clause: Malpractice, Diagnosis and Therapy*, në *The International Practice of Law: Liber Amicorum for Thomas Bär and Robert Karrer*, Nedim Peter Vogt (editor), Basel: Helbing & Lichtenhahn, 1997,
- Rebecca M.M. Wallace, *International Law*, London: Sweet&Maxwell, 1986,
- Gary B. Born, *International Arbitration and Forum Selection Agreements: Drafting and Enforcing*, Alphen aan den Rijn: Kluwer Law International, 2010,
- Fouchard, Gaillard, Goldman, Emmanuel Gaillard, John Savage (editors), *International Commercial Arbitration*, Kluwer Law International, The Hague, London/New York, 1999,
- Gašo Knežević, Vladimir Pavić, *Arbitraža i ADR*, Beograd: Pravni Fakultet Univerziteta u Beogradu, 2009
- Drita M. Fazlia, Faton Shabani, *Zgjidhja jashtëgjyqësore e kontesteve*, Arbëria Design, Tetovë, 2019
- European Convention for the Peaceful Settlement of Disputes (1957)
- Michael Hwang, Fong Lee Cheng, *Relevant Considerations in Choosing the Place of Arbitration*, *Asian International Arbitration Journal*, 4/2, 2008,
- Дејан Јанићијевић, *Арбитражни споразум као основ арбитражног решавања вишестраних и комплексних спорова*, *Зборник радова Правног Факултета у Нишу*, LIV,
- Љубомир Данило Фрчкоски, Сашо Георгиевски, Татјана Петрушевска, *Меѓународно јавно право*, Скопје, Зумпрес, 1995
- Convention for Pacific Settlement of International Disputes (1899).
- Convention for Pacific Settlement of International Disputes (1907)
- American Treaty on Pacific Settlement (1948)
- Model Rules on Arbitral Procedure (1958)